



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

FT O J

Mbledhjen e parë e K.K-së,s, e cila do të mbahet më **26.01.2022** (e mërkurë) duke filluar në ora **10:00**.

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së Novobërdë;
2. Anulimi i vendimit të aprovuar në mbledhjen e kaluar për formimin e KPF-së;
3. Formimi i KPF-së në bazë të Ligjeve në fuqi (duke e respektuar barazin gjinore);
4. Formimi i Komitetit për Komunitete në bazë të Ligjeve në fuqi (duke e respektuar barazin gjinore);
5. Raporti financiar për tremujorin e katërt financiar Tetor - Dhjetor për vitin 2021;
6. Propozimi i orarit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit Komunal për vitin 2022;
7. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 18.01.2022
Në: Novobërdë



Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 14.12.2021, duke filluar në orën 11:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryetari i Komunës Sasa Milosevic, Nënkryetari i Komunës për Komunitet Bajrush Ymeri, Nënkryetari i Komunës Svetislav Ivanovic, antarët e Kuvendit: Ivana Ivanovic, Ramush Mehmeti, Stefan Kovacevic, Stojan Stanojevic, Mirjana Simijonovic, Dragana Dimic, Violeta Milosevic, Xhevat Mehmeti, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Vlora Vllasaliu, Abdyl Gashi, Ivica Cenic, përfaqësuesit e OSBE-së, zyrtare komunal dhe qytetarë.

Mbledhjen e udhëheqi antari më i vjetër i Kuvendit Stojan Stanojevic i cili pasi pershendeti të pranishmit tha: para se të fillojmë me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimmarrje dhe po fillojmë mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Novobërdës;
3. Caktimi i zëvendëskryesuesit të Kuvendit Komunal të Novobërdës;
4. Zgjedhja e nënkryetarit për Komunitete të Komunës së Novobërdës;
5. Formimi i Komitetit për Politik dhe Financa;
6. Formimi i Komitetit për Komunitete;
7. Të ndryshme.

Anëtari më i vjetër i Kuvendit i pyeti antarët e Kuvendit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Pasi nuk pati propozime aprovohet njëzëri rendi i ditës nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Anëtari më i vjetër e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbali njëzëri nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë: Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Novobërdës;

Anëtari më i vjetër i Kuvendit tha: në bazë të nenit 41 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale Kuvendi i Komunës duhet të zgjedh Kryesuesin e Kuvendit nga radhët e anëtarëve të Kuvendit, por së pari duhet të propozohet komisioni prej tre anëtarëve që do të mirret me procesin e votimit për zgjedhjen e Kryesuesit.

Ramush Mehmeti propozon Xhevat Mehmetin.

Ivica Cenic propozon Milica Jovanovic.

Milica Jovanovic propozon Stefan Kovacevic.

Antari më i vjetër i Kuvendit Stojan Sanojevic kërkoj propozimet për Kryesues të Kuvendit.

Stefan Kovacevic pasi pershendeti të pranishmit propozoj Mirjana Simijonovic për Kryesuese të Kuvendit. Xhevat Mehmeti propozon Vlora Vllasaliu për Kryesuese të Kuvendit.

Anëtari më i vjetër i Kuvendit tha: pasi kemi dy kandidatë vazhdojmë me votim, deri sa komisioni të pregaditet për procesin e votimit kerkoj pauzë 10min.

Pas pauzes 10min. mbledhja vazhdoi dhe Kryetar i Komisionit u zgjedh Xhevat Mehmeti i cili fillimisht i njoftoi antarët e Kuvendit rreth procesit të votimit dhe i ftoj të gjithë antarët e Kuvendit me radhë për votim.

Pas përfundimit të procesit të votimit Kryetari i Komisionit Xhevat Mehmeti konstatoi se: kanë votuar të gjithë anëtarët e Kuvendit, e hapi kutin për numërim të votave dhe pas numërimit konstatoi se 14 vota janë për Mirjana Simijonovic dhe 1 për Vlora Vllasaliu.

Anëtari më i vjetër i Kuvendit Stojan Stanojevic tha: në bazë të konstatimit të komisionit Kryesuese e Kuvendit zgjedhet Mirjana Simijonovic me 14 vota për, e ftoj Kryesuesen që ta zë vendin në ulësen e saj.

Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: i falenderoj anëtarët e Kuvendit për besimin e dhënë për Kryesuese të Kuvendit dhe besoj se në të ardhmen do të udhëheq mirë Kuvendin dhe me forca të përbashkëta do të arrijmë të bëjmë një punë më të mirë në Kuvend. Kryesuesja vazhdoi me pikat e radhës.

Pika e tretë: Caktimi i zëvendëskryesuesit të Kuvendit Komunal të Novobërdës;

Mirjana Simijonovic tha: në bazë të nenit 54 pika 2 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale postin e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete e mban kandidati përfaqësues i popullatës jo shumicë që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në Kuvendin e Komunës dhe ai është Ramush Mehmeti.

Pika e katërt: Zgjedhja e nënkryetarit për Komunitete të Komunës së Novobërdës;

Mirjana Simijonovic tha: në mbështetje të nenit 61 të ligjit nr.03/L-40 për Vetqeverisjen Lokale, kandidati që ka më së shumti vota nga komuniteti shqiptarë propozohet për nënkryetar të komunitetit shqiptarë, në këtë rast propozoj Bajrush Ymerin i cili fitoi 1300 vota.

Mirjana Simijonovic i ftoj anëtarët e komunitetit shqiptarë që të votojnë.

Për nënkryetar të komuniteteve votuan 3 për dhe 2 kunder (Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu) nga antarët e komunitetit shqiptarë të Kuvendit.

Më pastaj Kryesuesja i ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit për votim.

Me 12 vota për, 2 kunder dhe 1 apstenim zgjedhet Bajrush Ymeri nënkryetar për komunitete dhe mirret ky:

VENDIM

ZGJEDHET z.Bajrush Ymeri Nënkryetar i Komunës së Novobërdës për Komunitete.

Pika e pestë: Formimi i Komitetit për Politik dhe Financa;

Mirjana Simijonovic tha: në bazë të nenit 52 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale duhet të formohet Komiteti për Politik dhe Financa, nga Kuvendi duhet të propozohen katër anëtarë.

Negovan Jovanovic propozoi Violeta Milosevic.

Milica Jovanovic propozoi Dragana Dimic.

Ramush Mehmeti propozoi Vlora Vllasaliu.

Selatin Nuhiu propozoi Abdyl Gashi.

Mirjana Simijonovic tha: i kemi propozimet: Violeta Milosevic nga SL, Dragana Dimic nga SL, Vlora Vllasaliu nga LDK dhe Abdyl Gashi nga VV.

Procesverbali i Kuvendit

Zv.kryesusi Ramush Mehmeti tha: vetem një sqarim kryesuesja e Kuvendit zgjedhet me automatizem edhe kryesuese e KPF-së, dmth gjithësej i kemi 5 anëtar me kryesuesen, dy anëtar nga komuniteti shqiptarë, dy anëtar nga komuniteti serb.

Kryesuesja e hudhi ne aprovim formimin e KPF-së.

Me 15 vota për nga të gjithë anëtarët prezent të Kuvendit aprovohet formimi i KPF-së dhe mirret ky:

VENDIM

ZGJEDHET Komiteti për Politikë dhe Financa në Komunën e Novobërdës me këtë përbërje:

1. Mirjana Simijonovic - LS
2. Violeta Milosevic - LS
3. Dragana Dimic - LS
4. Vlora Vllasaliu - LDK
5. Abdyl Gashi - VV

Pika e gjashtë: Formimi i Komitetit për Komunitete;

Mirjana Simijonovic tha: në bazë të nenit 53 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale obligativ është të formohet edhe komiteti për komunitete ku përfshihen anëtarët nga Kuvendi dhe anëtarët tjerë janë përfaqësuesit nga komunitetet, andaj kërkoj propozimet e juaja nga Kuvendi.

Ivana Ivanovic propozon Negovan Jovanovic.

Ivica Cenic propozon Dobrivoje Djordjevic.

Ramush Mehmeti propozon Xhevat Mehmetin dhe Selatin Nuhiu.

Ramush Mehmeti tha: sot do të votohen vetem anëtarët nga Kuvendi për komitet ndërsa pas kësaj mbledhje Kryesuesja do ti filloj procedurat për zgjedhjen e përfaqësuesve nga komunitet që zgjedhen në bazë të numrit të nënshkrimeve.

Mirjana Simijonovic tha: i kemi propozimet për anëtarë të komitetit për komunitete nga Kuvendi: Negovan Jovanovic, Dobrivoje Djordjevic, Xhevat Mehmeti, Selatin Nuhiu.

Kryesuesja e hudhi në votim formimin e komitetit.

Me 15 vota për aprovohet formimi i komitetit për komunitete nga anëtarët e Kuvendit Komunal.


Pika e shtatë: Të ndryshme;

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.


Pasi nuk pat diskutime Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:45.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

DATË/A:	18.01.2022
PËR/ZA/TO:	Antarët e Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	Mirjana Simijonovic - Kryesuese e Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal për vitin 2022

Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2022.

Nr	Dita	Data	Koha	Vendi
1.	E mërkurë	26.01.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
2.	E hënë	28.02.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
3.	E enjte	31.03.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
4.	E enjte	28.04.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
5.	E martë	31.05.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
6.	E enjte	30.06.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
7.	E enjte	28.07.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
8.	E enjte	08.09.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
9.	E enjte	29.09.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
10.	E hënë	31.10.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
11.	E mërkurë	30.11.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
12.	E enjte	29.12.2022	10:00	Salla e Kuvendit Komunal